



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 5
Prishtinë, më 18.12.2017, me fillim në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit , salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Igor Simić, kryetar, Danush Ademi, nënkryetar i dytë, Zoran Mojsilović, Jasmina Zhivković, Sasha Milosavljević, Rasim Selmanaj, Albert Kinoli, Mufera Srbica-Sinik i Duda Bale, anëtarë.
Munguan; Xhelal Sveçla, Kujtim Shala dhe Fadil Beka.

Pjesëmarrës të tjerë: vëzhguesi nga OSBE-ja , përfaqësuesi i Këshillit Konsultativ për Komunitete pranë Zyrës së Kryetarit të Republikës së Kosovës.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: Natasha Prica-Tishma, koordinatorë dhe Drita Çarkaxhiu, zyrtare e lartë ligjore.

Mbledhjen e kryesoi: **Igor Simić**, kryetar i Komisionit.
Për këtë mbledhje u propozua ky,

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve të datave 26.10.2017; 30.10.2017 dhe 15.11.2017,
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-019 për standardizimin dhe Raportit me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal,
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-020 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, për ministrinë e resorit.

I ftuar: Ministri i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, z. **Dalibor Jevtić**.

5. Të ndryshme.

1, Kryetari, e hapi mbledhjen dhe konstatoi se rendi i ditës u miratua pa vërejtje. Në të njëjtën kohë, propozoi ndryshimin e radhitjes për shqyrtim të pikave të rendit të ditës, në mënyrë që pikë e parë të jetë pika e katërt: Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-020 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, për ministrinë e resorit, propozim ky që u përkrah.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-020 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, për ministrinë e resorit,

I ftuar: Ministri i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, z. Dalibor Jevtiç.

Kryetari, e përshëndeti përgjigjën e ministrit të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, z. Dalibor Jevtiç, rreth ftesës për pjesëmarrje në mbledhje, për të raportuar para Komisionit në lidhje me Projektligjin nr.06/L-020 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, për ndarjet buxhetore për Ministrinë për Komunitete dhe Kthim. Pastaj ftoi anëtarët e Komisionit që të inkuadrohen në diskutim, të parashtrojnë pyetje, t'i paraqesin sygjerimet e veta dhe rekomandimet eventuale për çështjet për të cilat po diskutohet.

Ekspozeu hyrës i ministrit Dalibor Jevtiç

Ministri për Komunitete dhe Kthim, z. **Dalibor Jevtiç**, theksoi se me buxhetin për vitin 2018, për nevojat e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, janë ndarë 6.900.000 € dhe nga kjo shumë, për investime kapitale që d.m.th. për projekte për personat e zhvendosur janë ndarë gjithsej 1.000.000 €, për projekte të ndryshme për të kthyerit (në radhë të parë për ndërtimin e shtëpive), janë ndarë gjithsej 2.400.000 €, kurse shumat e mbetur prej 3.500.000 € është destinuar për infrastrukturë dhe për nevoja tjera të ndryshme.

Edhe pse në vitin 2017, buxheti për Ministrinë për Komunitete dhe Kthim ka qenë përgjysmë më i vogël nga sa është paraparë, ne si institucion jemi përgjegjës në kërkesat e komuniteteve joshumicë, në pajtim me përparësitë e dërguara.

Besoj se viti i ardhshëm do të jetë më i mirë, për shkak se buxheti i MKK-së është dukshëm më i madh dhe i ftoj të gjitha institucionet që çdo trup qeveritar, në mënyrë të barabartë, të ndihmojnë dhe të kyçen në procesin e kthimit dhe të jenë pjesë e këtij procesi, si dhe në zgjidhjen e çështjes së pozitës së komuniteteve joshumicë, sepse vetëm kështu mund ta çojmë përpara pozitën ekonomike të komuniteteve në fusha të ndryshme të jetës, theksoi z. Jevtiç.

„Do të mundohemi që, projektet të cilat nuk kemi mundur t'i realizojmë për shkak të problemeve me buxhetin, t'i realizojmë këtë vit. Nëse marrim parasysh se në vitin 2017 kemi pasur 343 të kthyer, më së shumti nga radhët e komunitetit rom, sidomos nga Mali i Zi dhe Maqedonia, ky është edhe një tregues se ky vit ka qenë vërtet me shumë probleme. Megjithatë, pa marr parasysh një buxhet të përgjysmuar, kemi hartuar një plan të mirë që ta përmbushim një pjesë të asaj që e kemi planifikuar theksoi z. Jevtiç.

Pjesët kryesore të buxhetit , d.m.th. linja buxhetore për këtë Ministri parasheh:

Shpenzimet për paga dhe dieta në shumën prej 796.000 € , për mallra dhe shërbime në shumën prej 375,652 €, për komunalitet në shumën prej 16,154 € dhe për subvencione dhe transferte në shumën prej 300,000€.Për investime kapitale kësaj Ministrie i janë ndarë mjete në shumën prej 6.900.000 € e që ndahen në tri kategori: projekti për kthim dhe riintegrim, përkatësisht për ndërtimin e shtëpive për banim në shumën prej 2.400.000 €, që drejtpërdrejt financohet nga Ministria dhe projekti për komunitete në shumën prej 3.500.000 €, për fuqizimin e qëndrueshmërisë ekonomike, pastaj në lëmin e arsimit, informimit, mediave, sportit, kulturës, në kuadër të bashkëpunimit dhe memorandumeve të lidhura.

Ministria ka hartuar edhe udhëzime të posaçme për subvencionimin e projekteve dhe aktiviteteve që i definojnë procedurat e subvencioneve, monitorimi dhe implementimi i projekteve. Në pajtim me këto, shqyrtohen kërkesat e qeverisjeve lokale (të personave juridik) dhe atyre fizik për ndarjen e mjeteve buxhetore në bazë të memorandumeve të lidhura dhe bashkëpunimit me Zyrën e BE-së.

Pyetjet:

Igor Simiç, kryetar i Komisionit, parashtroi disa pyetje:

1. Sa është shkalla e shfrytëzimit të buxhetit nga ministrinë në perudhën e mëparshme, duke e lënë pasdore këtë vit, meqë theksuat se ka pasur probleme të caktuara në implementim?
2. Si është bashkëpunimi në mes të Ministrisë për Komunitete dhe ministrive tjera?
3. A është e mundur që, secili komunitet në secilën ministri, individualisht ta ketë kodin e vet buxhetor?

Mufera Srbica – Sinik - Tani kur jemi në fazën e shqyrtimit të buxhetit për vitin 2018, Grupi parlamentar 6+, Komisionit për Buxhet dhe Financa, ia paraqiti disa amendamente që kanë të bëjnë me komunitetin turk. Tri (3) amendamente i kam paraqitur unë në cilësinë e deputetit. Kam kërkuar që të ndahen mjete buxhetore për botimin dhe shtypjen e librave, ushtrimoreve dhe pajisjeve tjera shkollore për nxënësit nga klasa e I-rë e deri te klasa e V-të në gjuhën turke, në shumën prej 200.000 €, por i njëjti nuk është miratuar, përkatësisht nuk ka marrë përkrahjen e nevojshme nga komisioni funksional.

Gjithashtu, shfrytëzoj rastin të paraqes të dhënat se, në shkollat ku mësimi zhvillohet në tri gjuhë, (shqip, turqisht dhe boshnjakisht), nuk ka të punësuar asnjë pedagog dhe psikolog, që është e papranueshme nga aspekti i strukturës së kuadrove shkollore.

1. Në këtë aspekt, a ekziston mundësia për ndarjen e mjeteve të caktuara me qëllim të implementimit të këtij plani për të cilin fola?
2. A ka pasur Ministria kërkesa buxhetore për kthim të pjesëtarëve të komunitetit turk dhe sa mjete buxhetore nga buxheti i vet i ka ndarë Ministria për komunitetin turk?

Duda Balje- Dëshiroj të paraqes faktin që deri më tani komuniteti boshnjak nuk ka qenë i kënaqur me ndarjen e mjeteve buxhetore për komunitetet tjera, për zgjidhjen e shumë çështjeve me rëndësi. Mu për këtë, ne si grup parlamentar që përbëhet nga 4 komunitete, në konsultim me ministrin, jemi munduar që pakënaqësinë tonë ta shprehim përmes plotësimit të pjesës tekstuale të Ligjit për buxhetin, përkatësisht të plotësojmë nenin 12, i cili do të rregullonte ndarjen proporcionale të buxhetit nëpër komunitete, sepse kjo është mënyra më e mirë e paraqitjes së interesave të tyre. Pyetja ime është:

1.Me cilën metodologji Ministria bënë ndarjen e mjeteve buxhetore për komunitete?

Në ekspozë u përmend edhe bashkëpunimi me qeverisjen lokale. Në mandatin e kaluar, së bashku me juve dhe me përfaqësuesit e Zyrës për Komunitete të komunës së Prizrenit dhe të Dragashit, kam pasur rastin të marr pjesë në takim te ju, për t'i paraqitur kërkesat konkrete , prioritetet tona dhe të kërkojmë ndihmë. Këto kërkesa buxhetore datojnë plotë që tri vite buxhetore.

Ministria duhet që, në periudhën e ardhshme, të realizojë bashkëpunim të plotë dhe të afërt për të gjitha çështjet nga kompetencat e veta, në kuptim të shkëmbimit të mendimeve të përbashkëta dhe identifikimin e problemave, në mënyrë që komuniteteve t'u ndihmohet në mënyrë adekuate, duke bërë përpjekje që, në procesin buxhetor MKK të ndajë më shumë mjete buxhetore për realizimin e qëllimeve të përcaktuara në raport me komunitete.

Në këtë kuptim, përshtypja e përgjithshme jep pamje të keqe sa i përket bashkëpunimit dhe mu për këtë ekzistojnë arsye të ndryshme për pakënaqësi në aspektin e bashkëpunimit dhe komunikimit , prandaj pyetja ime është::

2. A është e mundur të përmirësojmë bashkëpunimin , marrëdhëniet dhe koordinimin me komunitete me përgjegjësi të plotë të Ministrisë dhe detyrave që i ka në kompetencën e vet.

3. Unë si përfaqësues legjitim i komunitetit boshnjak dëshiroj të di se me sa përqind të buxhetit të Ministrisë për vitin 2017, merrë pjesë komunitetit boshnjak ?

Për mua këto çështje janë të realizueshme, me një qëllim shumë konkret përfundoi ajo.

Xhelal Sveçla - Duke u ndërlidhur me diskutimet e mëparshme, dhe me vet faktin se jam deputet i ri në këtë mandat, mendoj se institucioni i ministrisë ka për detyrë t'i mbrojë të gjitha komunitetet pa diskriminim e favorizim të njërit në raport me komunitetin tjetër, nga aspekti i ndarjes së buxhetit për komunitete. Sot, por edhe më herët, nga përfaqësuesit e komuniteteve kemi dëgjuar që ekzistojnë vërejtje të caktuara sa i përket ndarjes së buxhetit për komunitetin serb në raport me komunitetet tjera.

1. Për çka është formuar Ministria dhe cili është roli i saj?
2. Cili është çelësi për përcaktimin e projekteve dhe ndarjen e buxhetit për vitin vijues në mes të komuniteteve në Kosovë?

Albert Kinoli - Më intereson konkretisht:

Cili është numri i familjeve romë të kthyera nga Mali i Zi dhe Maqedonia, të cilave u janë ndërtuar shtëpitë, duke u bazuar në të dhënat e vitit 2017, se ai numër është 323 dhe prej tyre shumicën e përbëjnë pjesëtarët e komunitetit rom.

Rasim Selmanaj - Meqë jam deputet i ri, kam vërejtur se në disa mbledhje radhazi debatojmë për të njëjtën temë. Propozoj që, përfaqësuesit e komuniteteve në Kuvend, të mbajnë konsultime me ministrin rreth planifikimit të buxhetit dhe atë para se i njëjti të dërgohet për shqyrtim në Kuvend. Mendoj se ky process do të ishte korrekt dhe i zbatueshëm

Jasmina Zhivkoviç - Nuk pati pyetje konkrete të lidhura me resorin e buxhetit, por theksoi faktin dhe shprehi falënderim ndaj ministrisë për punën në terren me komunitete. Gjithashtu, falënderoi ministrin Jevtiç, duke theksuar se është i vetmi ministër që rregullisht u është përgjigjur ftesave të Komisionit, duke dhënë kontributin e plotë në realizimin e qëllimeve të planifikuara me interes për komunitetet.

Danush Ademi - Duke u ndërlidhur me diskutimet paraprake, shprehu shqetësimin e vet për situatën dhe pozitën shumë të vështirë ekonomike të komunitetit ashkalinjë. Duhet që, sa më pare, të ndermerren të gjitha masat e nevojshme për kapërcimin e kësaj gjendje.

Në shumë komuna, pjesëtarët e komunitetit tim nuk janë të punësuar në asnjë vend pune në administratën publike, e as në ato komuna ku ky komunitet bën pjesë me një numër relativisht të madh.

Sa i përket ndarjes së buxhetit, Ministria duhet të ketë qasje dhe tretman të barabartë me rastin e ndarjes së buxhetit për komunitete dhe në realizimin e buxhetit të destinuar për komunitete të bartë një pjesë të përgjegjësisë. Pra, problemet ekzistojnë dhe në terren janë evidente siç janë edhe problemet rreth ndarjes së mjeteve buxhetore në mënyrë adekuate.

Deri më tash, për komunitetin tim janë ndarë shumë pak në kuptim të segmentit të buxhetit dhe asistencës sociale të familjeve më të rrezikuara nga radhët e këtij komuniteti kur dihet gjendja në terren, ku janë janë shfaqur raste ekstreme të varfërisë me pasojë vdekjen. Duhet plotësuar nevojat dhe krijuar kushtet për jetesë atyre që jetojnë në Kosovë, e jo t'u ipet pëparësi të kthyerve nga shtetet e Evropës. Unë jam kundër një strategjie të tillë.

Gjithashtu, sa i përket informimit dhe bashkëpunimit, dëshiroj të theksoj se duhet riaktivizuar të gjitha aspektet e bashkëpunimit për një koordinim sa më kualitativ, në drejtim të zgjidhjes së problemeve të përbashkëta me përfaqësuesit lokal e qendror, që do të rezultonte me sukses në punën e gjithmbarshme të Ministrisë. Në këtë plan duhet bërë më tepër.

Komentet dhe përgjigjet e ministrit në pyetjet dhe sygjërimet e parashtruara

Për çështjet e lidhura me buxhetin e vitit 2017, ministri Jevtiç theksoi se 98% e të njëjtit është shfrytëzuar edhe pse jemi para rrethanave të reja (përgjysmimit të buxhetit me rebalanc të 2017), për një kohë të shkurtë, kemi hartuar një plan të mirë që nga mjetët e mbetura, të ndërtohen 17 shtëpi për pjesëtarë të komunitetit rom. Ka filluar ndërtimi i 5 prej 13 shtëpive për të kthyerit në fshatin Lubozhdë- Komuna e Istogut, të gjitha me qëllim që të bëhet diçka nga ajo që është planifikuar.

Sa i përket procesit të shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave buxhetore, Ministria ka hartuar Udhëzim të posaçëm për subvencionimin e projekteve dhe aktiviteteve, të cilat definojnë procedurat e subvencionimit, monitorimin dhe implementimin e projekteve. Kërkesat buxhetore duhet adresuar ministrive kompetente dhe të mos ekzistojë metodologjia e e ministrisë me rastin e ndarjes së buxhetit për komunitete, por strategjia që d.m.th. udhëzimi përkatës.

Me amendamente nuk mund të kërkohen mjete buxhetore. Në pajtim me këto, shqyrtohen kërkesat e qeverisjeve lokale (të personave juridik) dhe personave fizik për ndarjen e mjeteve buxhetore në bazë të memorandumëve të ndërlidhura dhe bashkëpunimit me Zyrën e BE-së. Natyrisht, unë kisha dëshiruar që e gjithë kjo që bënë Ministria të shkojë më shpejtë, por procedurat duhet respektuar, si dhe afatet ligjore.

Përgjigjet në pyetjet për ndarjen e buxhetit për komunitetin boshnjak dhe pyetjet dhe kërkesat për kthimin e komunitetit turk, rom e boshnjak, në vitin 2017 janë ndarë 13% të buxhetit, kurse kanë qenë 343 kërkesa për kthim, para së gjithash më së shumti nga radhët e e komunitetit rom, nga Mali i Zi dhe Maqedonia. Nga ky numër, në lokalitetet e Komunës së Gjakovës, janë ndërtuar 161 shtëpi.

Sa i përket kërkesave për kthim të komunitetit turk, në këtë vit nuk ka pasur asnjë kërkesë të tillë, kurse në vitet paraprake ka pasur disa kërkesa për kthim të turqve nga Komuna e Gjilanit e që janë realizuar.

Komentet dhe propozimet në lidhje me informimin dhe bashkëpunimin, dua të theksoj se duhet zbatuar të gjitha format e bashkëpunimit, për koordinim kualitativ në kuptim të përfshirjes edhe të institucioneve tjera në zgjidhjen e problemeve në vijim.

MKK është e gatshme për të gjitha format e bashkëpunimit në hartimin e politikave të caktuara dhe qasjen ndaj komuniteteve, me qëllim të një operativiteti më të mirë në punë për të gjitha çështjet nga kompetenca e vet.

Është formuar “Grupi ndërministror për çështje të komuniteteve”. Ky grup merret me komunitete, anëtar i të cilit jam edhe unë dhe ministra tjerë nga komunitetet joshumicë, por edhe nga minsitritë me rëndësi të veçantë për komunitete, ku do të merremi me çështjet e sigurisë, përdorimin e gjuhëve, përfaqësimin e komuniteteve në institucionet publike, me bujqësi, si dhe me pronën e uzurpuar.

Vendimet dhe rekomandimet të cilat i miraton komisioni, e kanë të njëjtin tretman sikur të miratoheshin në mbledhjet e Qeverisë dhe mendoj që përmes këtij mekanizmi të përmirësojmë situatën në këto lëmi, si dhe zbatimin e ligjeve për komunitete që do të kontribuojnë në promovimin e bashkëjetesës dhe përmirësimin e të drejtave të komuniteteve në terren.

Arsyeja kryesore e formimit të Ministrisë për Kthim dhe Komunitete është vet fakti që pas luftës së vitit 1999 kemi pasur rreth 250.000 persona të zhvendosur, kryesisht pjesëtarë të komunitetit serb, dhe e dyta që të ekzistojë institucioni për zgjidhjen e këtyre çështjeve.

Kryetari hapi për shqyrtim pikën e dytë të rendit të ditës

3. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datës: 26.10.2017; 30.10.2017 dhe 15.11.2017.

Kryetari, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më: 26.10.2017, 30.10.2017 dhe 15.11.2017, pa vërejtje.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-019 për standardizim dhe Raportit me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal.

Pas shqyrtimit të Projektligjit dhe Raportit me amendamente të Komisionit Funksional, komisioni nxori këtë:

Përfundim

Projektligji nr.06/L-019 për Standardizim me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal nuk i cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit që i njehti të miratohet në lexim të dytë.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

Përgaditur nga njësia mbështetëse e komisionit

Kryetari i Komisionit

Igor Simić